POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Banorëve iu japin mundësinë të shohin si i kanë imituar në Protokalli, Kiara dhe Luizi të pakënaqur (VIDEO)
2 'Pritjes i erdhi fundi...!' motra e Luizit mbërrin në Tiranë! Çfarë do të ndodh nesër në Big Brother?
3 Të shtënat me armë në lokalin e Fatjon Muratit, policia nën vëzhgim 3 të dyshuar! Një prej tyre me precedent penal
4 A kanë kryer marrëdhënie seksuale nën jorgan Luizi dhe Kiara? Ja si përgjigjen banorët që ishin brenda shtëpisë së BBV
5 Sherr për gërvishtjen e makinës në Tiranë, disa persona në 'Zog të Zi' godasin njëri-tjetrin! Policia i shoqëron në komisariat (VIDEO)

Kronikë

Kërcënuan biznesmenin në Cërrik të tërhiqej nga tenderi që fitoi në Bashkinë e Tiranës për lëndë drusore, 3 të arrestuar në Elbasan (EMRAT)

Administratori i një kompanie private në Gramsh është kërcënuar me jetë nga 4 persona që i kanë kërkuar të hiqte dorë nga gara pre një tender publik që kishte fituar në Bashkinë e Tiranës. Në pranga ka rënë pronari i kompanisë "Alcani", Shaqir Alcani pas denoncimit të Eral Myftarit.

■ Kërcënime për tenderat/ Softa: Ka shumë raste të tilla, jo të gjitha raportohen! Denoncimi i biznesmenit, kurajoz! Të ketë hetim të thelluar
■ Kanosja e biznesmenit në Cërrik, fituesi i tenderit dha ofertën më të ulët, kërcënuesit më të lartë
■ Pistoletë në kokë për t'u tërhequr nga tenderi, kush janë at e bir që kërcënuan biznesmenin në Cërrik (FOTOT)
■ 'Tërhiqu nga tenderi ose të vrasim!', kush është biznesmeni që u kërcënua në Cërrik

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

Banorëve iu japin mundësinë të shohin si i kanë imituar në Protokalli, Kiara dhe Luizi të pakënaqur (VIDEO)
10 Prill, 17:40

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
10 Prill, 10:50 | **Përditesimi: 10 Prill, 16:57**

ELBASAN- Eral Myftaraj, administrator i firmës "Almex greenwood" me qendër në Cërrik, është kërcënuar me jetë nga 4 persona që të tërhiqej nga tenderi që kishte fituar në bashkinë e Tiranës për furnizimin me lëndë drusore nëpër shkolla me vlerë 853 mije euro. Policia ka arrestuar Algert Alcani, 27 vjeç, Edmir Boci, 37 vjeç, Shaqir Alcani, 62 vjeç, të tre banues në Tiranë, si dhe ka shpallur në kërkim L. K., 38 vjeç.

Në dokumentin e Prokurimit Publik, siguruar nga Report Tv, në garë kanë marrë pjese tre kompani "ALCANI sh.p.k, REDI PELLET sh.p.k dhe AL-MEXWOOD sh.p.k. Kompania fituese me ofertën me të ulët me vlere rreth 565€ është shpallur AL-MEXWOOD sh.p.k e Myftarajt.

LEXO EDHE:
Lista e këshilltarëve socialistë nis fushatën me mbjellje pemësh, Gjiknuri: Kjo skuadër, garanci që Elbasani nuk do të ndalet

Shaqir Alcani pronar i kompanisë ALCANI sh.p.k ka kërcënuar me jetë Erald Myftarajn që të tërhiqet nga gara për tenderin e ngrohjes në shkolla. Pavarësisht kërcënimeve të vazhdueshme për jetën e tij dhe të familjarëve, Myftaraj nuk ka pranuar të tërhiqet, por ka denoncuar në policinë e Elbasanit.

Mbi bazë të këtij denoncimi blutë e Elbasanit vunë në pranga 3 persona dhe shpallën në kërkim një të katërt. Nga të dhënat në QKR, Shaqir Alcani rezulton pronar i kompanisë 'Alcani sh.p.k.', përfituese e 28 tenderave me vlerë 400 mijë euro, 13 prej të cilave i ka fituar më herët në bashkinë e Tiranës.

Sipas policisë ata kanë kërcënuar Eral Myftarjan se do ti vrisnin familjarët nëse nuk tërhiqej nga tenderi. Shaqir Alcani me të birin dhe mikun e tyre akuzohen për "Shtrëngim me anë të kanosjes" kryer në bashkëpunim. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar makina dhe 8 aparate celulare.


OKB

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J91505006Q
2. Data e Regjistrimit	01/06/1998
3. Emri i Subjektit	ALCANI SHPK
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	09/05/1995
6. Kohëzgjatja	Nga: 09/05/1995
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kamez KAMEZ Blloku "Frutikulture", rruga e Laknasit, 100 m prane ures.
8. Kapitali	31.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	310.000,00
9. Objekti i aktivitetit	Shfrytezim pyjesh, perpunim i lendes drusore, eksport - import te prodhimeve te drurit, tregtim te mallrave te ndryshem industriale e ushqimore, tregtim te prodhimeve bujqesore e blegtorale.Permiresimin e pyjeve (ricungime e trajtim pyjesh me prerje kulrurore). Shfrytezim i qendrushem i pyjeve. Ndertimi e rrugeve pyjore Grumbullimi dhe vjelja e qendrueshme e prodhimeve pyjore dhe flores spontane mjekesore e tanifere. Ushtrimi i gjuetise sportive e turistike te faunes se eger etj.Transport i materialeve drusore me mjetet e vete shoqerise. Punime te ndryshme ndertimi, punime dheu, murature e betoni, ndertime civile, kanalizime, rruge, ujesjellesa, rikonstruksione, prodhime materialesh ndertimi etj.Bar kafe, restorant. Kerkime, zbulime dhe shfrytezime minerare.Hartimi dhe zbatimi i planeve te menaxhimit ne pyje. Mbledhje dhe perpunimi i farave, prodhimi i fidaneve, kultivimi dhe mbjellja e tyre. Punime ne pyllzime, rehabilitime, sherbime kulturore, permiresime dhe riperteritje pyjesh, luftim insektesh dhe semundjesh. Ndertim pritash malore, lera (betoni e plasmasi), garbione, ndertim gjerdhesh, punime ne kullota e livadhe.Punime kujdesimi ne pyje me statusin e Zones se Mbrojtur. Krijimin e

1

Kopje nga web

(Kliko këtu për të parë dokumentin e plotë)

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:47

Pistoletë në kokë për t'u tërhequr nga tenderi, kush janë at e bir që kërcënuan biznesmenin në Cërrik (FOTOT)

Shaqir Alcani, Algert Alcani, Edmir Boci

Report Tv ka siguruar fotot e tre të arrestuarve nga policia në Elbasan të cilët akuzohen se kanë kërcënuar me pistoletë në kokë një biznesmen të tërhiqej nga tenderi që ka fituar në Bashkinë e Tiranës.

Në foto janë at e bir, Shaqir Alcani, 62 vjeç, dhe Algert Alcani, 27 vjeç si dhe bashkëpunëtori i tyre Edmir Boci, 37 vjeç.

Ora 13:40

Kanosja e biznesmenit në Cërrik, fituesi i tenderit dha ofertën më të ulët, kërcënuesit më të lartë

Biznesmeni Eral Myftaraj është kërcënuar nga biznesmeni Shaqir Alcani që të tërhiqej nga një tender ku ishin të dy konkurrues për ta përfituar.

Në bazë të të dhënave që disponon Shqiptarja.com më datë 4 prill biznesmeni Eral Mytaraj është shpallur fitues i një tenderi për blerjen e lëndëve djegëse dhe shpërndarje në objektet arsimore me kompania AL-MEXWOOD sh.p.k. Sipas të dhënave fituese është shpallur kompania AL-MEXËOOD sh.p.k. me ofertën më të ulët prej 63 859 260 milionë lekë.

Në garë ishte edhe kompania e Alcani sh.p.k e cila ka dhënë ofertën më të madhe prej 96 001 754.2 milionë lekë.

Po ashtu në garë ishte edhe kompania REDI PELLET sh.p.k, e cila është shkualifikuar pasi nuk plotësonte kriteret teknike.


Blerje lëndë djegëse pellet dhe shpërndarje në objektet arsimore

Autoritet Prokurues	Qeverisja Vendore Tiranë
Institucioni Prokurues	Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tirane
Objekti i Tenderit	Blerje lëndë djegëse pellet dhe shpërndarje në objektet arsimore
Nr. Reference	REF-58319-02-07-2023
Vlera / Fondi Limit	96 427 482,00
Lloji i Kontrates Publike	Blerje Mallrash (Marrëveshje Kuadër)
Lloji i Procedures	E hapur, mbi kufirin e lartë monetar
Statusi i Tenderit	Njoftuar Fituesi
Data e Njoftimit te Tenderit	08-02-2023
Data e fundit per dorezimin e Dokumenteve	10-03-2023
Data e mbajtjes se tenderit	10-03-2023
Nr. i Operatoreve Konkurues	3
Operatore Konkurues	1. ALCANI sh.p.k 2. REDI PELLET sh.p.k 3. AL-MEXWOOD sh.p.k
Operator Ekonomik Kontraktues	ALMEXWOOD SHPK
Oferta fituese Leke pa TVSH	63 859 260,00
Data e shpalljes se fituesit	03-04-2023
Vlera e kontraktuar Leke me TVSH	
Data e lidhjes se kontrates	
Kohezgjatja e kontrates	12 (dymbëdhjetë) muaj (Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër)
Shtese kontrate (Leke me TVSH	
Ankesa	Eshte skualifikuar operatori ekonomike i meposhtem: 1. REDI PELLET sh.p.k. per arsye: -Nuk ploteson piken 2.3.6.Kapaciteti teknik pasi nuk ka paraqitur mostrat sipas Kerkesave te DST
Arsyeja e Anulimit	
Shenime	
Transaksione Thesari	

Të dhënat e tenderit të fituar nga kompania 'AL-MEXWOOD sh.p.k

Buletini i Prokurimeve Publike

Njoftimi i Tenderit
Dokumentat Standarde te Tenderit
Shpallja e Fituesit
Lidhja e Kontrates
• Procesverbal "Per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim"
• Procesverbal "Per percaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës ne lote"

Të dhënat e tenderit të fituar nga kompania 'AL-MEXWOOD sh.p.k

Ora 12:17

'Tërhiqu nga tenderi ose të vrasim!', kush është biznesmeni që u kërcënua në Cërrik

Eral Myftaraj është biznesmeni që është kërcënuar me jetë nga katër persona, të cilët i kanë kërkuar që të tërhiqet nga një tender që kishte fituar me kompaninë e tij.

Algert Alcani, 27 vjeç; Edmir Boci, 37 vjeç, Shaqir Alcani, 62 vjeç dhe i shpallur në kërkim, 38-vjeçari me inicialet L.K., kanë kërcënuar Myftarajn me jetë duke i thënë se do të vrasim.

Bëhet fjalë për tenderin 1 milion eurosh për furnizimin me lëndë drusore. Myftaraj nuk është tërhequr dhe katër personat e kanë kërcënuar se do t'i vrisnin anëtarët e familjes.

M.Q./B.K./Shqiptarja.com

TAG: eral myftaraj, tender, cerrik, shaqir alcani, algert alcani, edmir boci, Elbasan

Komento

Komente

Tirona1: 10/04/2023 14:31
Erali eshte cun tirone dhe bob. Katunaret kujtojne se bohet cdo gjo me tfort e ne 2023. Te ishte per tforte ju kishte vra te treve. Por ka ndryshu koha o katunare kriminela.
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ketë javë nis zyrtarisht fushata për 14 Majin, si e prisni?
Të qetë | Të tensionuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Kërcënime për tenderat/ Softa: Ka shumë raste të tilla, jo të gjitha raportohen! Denoncimi i biznesmenit, kurajoz! Të ketë hetim të thelluar
10 Prill, 16:39

Gjiknuri prezanton Tafanin për Belshin: PS garanci për ndryshim rrënjësor të Belshit! Berisha ka hyrë te lista e Metës për t'i trashëguar partinë
8 Prill, 20:02

Bashkia: Rinis punën inceneratori i Elbasanit pasi ishte në remont, trajton 120 tonë mbetje urbane të 7 bashkive të qarkut
7 Prill, 20:39

Në kërkim të Suel Çelës? RENEA rrethon tregun agroushqimor të Elbasanit në pronësi të babait të tij, Petrit Çela! 4 të shoqëruar
7 Prill, 17:26


Dështon edhe sot nisja e gjykimit për inceneratorin e Elbasanit, e akuzuara duhet të ishte në 'arrest shtëpie' por policia nuk e gjen në banesë! Seanca më 20 prill
Keti Banushi
7 Prill, 15:26

Aksident në autostradën Elbasan-Tiranë, përplasen 2 makina! Një i plagosur
6 Prill, 18:08


Burri dhunon gruan në Belsh, e reja hidhet nga dritarja e banesës! Policia vë në pranga 35 vjeçarin
6 Prill, 13:00


EMRAT/ Kanosën me pistoletë një person në Gramsh! Arrestohen dy autorët! E pëson edhe 40 vjeçari i kërcënuar pasi dha dëshmi të rreme në polici
5 Prill, 11:27


Aksident në Elbasan, 61-vjeçari përplas 2 djemtë adoleshentë që po udhëtonin me biçikletë
4 Prill, 20:26


Aksident në rrugën Tiranë-Elbasan, mjeti tip 'volkswagen' përplaset me trajlerin! Plagoset një person (VIDEO)
4 Prill, 14:34


Vrasja e Pjerin Xhuvanit, shtyhet seanca ndaj Arbër Paplekajt! Prokuroria kërkon dëshminë e Bardhit, rrëzohet nga gjykata e Elbasanit
4 Prill, 09:13


VIDEO+ FOTO/ Aksident në rrugën Librazhd-Përrenjas, makina del nga rruga dhe bie në përrua, humbin jetën burrë e grua (EMRAT)
3 Prill, 09:05

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje